

**V E N D I M**  
**Nr. 407, datë 31.8.1999**

**PËR PRIVATIZIMIN ME ANKAND PA ÇMIM FILLESTAR TË PAKETAVE  
SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË DISA SHOQËRIVE TREGTARE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Privatizimin nëpërmjet shitjes me ankand pa çmim fillestar të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare si vijon:

|                                                  |     |
|--------------------------------------------------|-----|
| - Arteksportimport, sh.a. Tiranë                 | 51% |
| - Alimpeks, sh.a. Tiranë                         | 51% |
| - Frigoriferi, sh.a. Durrës                      | 51% |
| - Prodhime material ndërtimi, sh.a. Elbasan      | 51% |
| - Mekanika i industrisë ushqimore, sh.a. Elbasan | 51% |
| - Dinamo, sh.a. Tiranë                           | 51% |
| - Përpunim pesticide, sh.a. Durrës               | 51% |
| - Mobilje sh.a. Durrës                           | 51% |
| - Agroeksport sh.a. Tiranë                       | 51% |
| - NFN nr. 1, sh.a. Durrës                        | 51% |
| - NFN nr. 2, sh.a. Durrës                        | 51% |
| - Kaldaja, sh.a. Durrës                          | 51% |
| - Industrialimpeks, sh.a. Tiranë                 | 51% |
| - Uzina mekanike pjesë ndërrimi, sh.a. Durrës    | 51% |
| - NGP Drithi, sh.a. Korçë                        | 20% |
| - NF Komunikacion, sh.a. Durrës                  | 20% |
| - Tekstile, sh.a. Berat                          | 51% |
| - Frigorifer Dvoran, sh.a. Korçë                 | 30% |

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit anulon publikimin e filluar për këto shoqëri.

3. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë urdhrat përkatës, në përputhje me pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**